



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Ministri Bushati në Suedi: reforma në drejtësi, prioritet kryesor për integrimin, por dhe për qytetarin shqiptar e thithjen e investimeve

2018-01-13 10:56:00



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, gjatë vizitës në Suedi pati një takim me Kryetaren e Komisionit për BE-në parlamentin suedez, Karin Enström.

Të dy bashkëbiseduesit i kushtuan vëmendje të veçantë procesit të integrimin të Shqipërisë në BE, duke ndarë mendimin për rëndësinë që ka politika e zgjerimit në vendet e rajonit të Ballkanit dhe procesin e reformave në të. Ministri Bushati shprehu mirënjohjen për mbështetjen e qëndrueshme të Suedisë, përfshirë parlamentin suedez, për procesin e zgjerimit në një kohë kur BE po përballet me sfida të shumta dhe serioze. Znj. Enström rikonfirmoi qëndrimin suedez për anëtarësimin e rajonit, përfshirë Shqipërinë, në Bashkimin Evropian bazuar në meritë dhe plotësimin e kriterëve për këtë qëllim.

Në kuadër të vizitës në Suedi, Ministri Bushati zhvilloi një takim me Sekretarin e Shtetit në Ministrinë e Drejtësisë dhe Migracionit, Lars Westbratt.

Ministri Bushati e njohu Sekretarin e Shtetit Westbratt me ecurinë e reformave për afruesë me BE, duke u ndalur veçanërisht në reformën në drejtësi, si prioritet kryesor jo vetëm në rrugën e integrimin evropian të Shqipërisë, por dhe për qytetarin shqiptar dhe thithjen e investimeve të huaja në vend. "Shqipëria po zbaton një reformë gjithëpërfshirëse të drejtësisë që adreson mangësitë e deritanishme në lidhje me pavarësinë, llogaridhënien, efikasitetin dhe profesionalizmin e sistemit të drejtësisë. Zbatimi i legjislacionit tashmë në fuqi po zhvillohet me një ritëm të qëndrueshëm, si dhe po punohet për zbatimin e procesit të vetingut në të gjitha nivelet", vuri në dukje Ministri Bushati.

Bashkëbiseduesit ndanë mendime në lidhje me krizën migratore dhe impaktin e saj, si dhe vlerësuan bashkëpunimin mes dy vendeve për frenimin e fenomenit të azil-kërkimit.

Ministri Bushati zhvilloi edhe një takim me Sekretarin e Shtetit për

zhvillimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, Ulrika Modeer, si dhe me Sekretarin e Shtetit për BE-në dhe tregtinë Oscar Stenström.